



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AN.nr.97/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Mehmet Ndrecaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Lirie Bunjaku - Zhitia, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit J. K., të cilën me autorizim e përfaqëson avokat F. M., me seli në P., rr.”T. S.”, objekti nr.52/1, P., kundër të paditurës DKA-KFK, , me bazë juridike: kompensimin e pagave përcjellëse dhe shpërblimin jubilar, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në çështjen e paditësit J. K., kundër të paditurës DKA-KFK, është kompetente lëndore Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Paditësi J. K., me datë 13.09.2019, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, kundër të paditurës DKA-KFK, për kompensim të pagave jubilarë dhe përcjellëse.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me aktvendimin C.nr.3117/19, të datës 04.07.2022, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për shqyrtim dhe vendosje në këtë çështje dhe lëndën ia dërgon Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë me kompetencë lëndore për vendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.1895/2022, të dt.27.03.2023, hap konfliktin e kompetencës duke u bazuar në nenin 24 të LPK-së, pasi që vlerëson se në rastin konkret është kompetente pikërisht gjykata që është shpallur jo kompetente për të gjykuar këtë çështje pra Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të fakteve lidhur me kompetencën lëndore, pasi që nuk kërkohet anulimi i asnjë vendimi përfundimtar administrativ apo nxjerrje e aktit administrativ por se me padi baza juridike referohet në marrëveshjen e përgjithshme kolektive dhe kërkohet kompensimi mbi këtë bazë dhe me referim në këtë marrëveshje andaj në këtë kuptim konstatohet se Gjykata

Themelore në Prishtinë, ka kompetencën të vlerësimit të të drejtës së kërkuar përmes padisë nga paditësja sipas marrëveshjes së cituar.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjeti se e kompetencës lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese është Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, pasi që paditësi me padinë e tij ka kërkuar kompensimin për paga jubilarë dhe përcjellëse. Andaj, në bazë të nenit 13.1 të Ligjit për Konfliktin Administrativ nr.03/L-202 është përcaktuar se: *“Konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative të shkallës së dytë”*. Gjithashtu, me nenin 13 par.2 përcaktohet se *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë kundër të cilit në procedurë administrative ankimi është i lejuar”*. Po ashtu, neni 15.1.1 i të njëjtit ligj përcakton se: *“Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrative”*. Andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura pasi që çështja ka të bëjë me kompensimin pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe shpërblimin jubilar, dhe duke u bazuar dhe në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.nr.83/22 të datës 14.11.2022, në rastin konkret, kolegji vlerëson se kompetente për gjykim të kësaj çështje juridike është ekskluzivisht Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Në kuptim të arsyeve të sipër theksuara, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë e ka hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestuese duke u bazuar në nenin 24 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në pajtim me dispozitën e nenit 25 paragrafi 1 i LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AN.nr.97/2023, me datë 29.08.2023

Kryetare e Kolegjit,
Delushe Halimi